



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA JURIDIKE DHE PËRPUTHSHMËRISË SË STANDARDEVE
SEKTORI I PROKURIMEVE**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIT**

28.07.2025

Drejtuar: **Operatorit Ekonomik “I.D.K-KONSTRUKSION” SHPK** **K51408016J**

*Tiranë, Autostrada Tiranë-Durrës, Km.12, Rruga Zaja, Koder Berxulle, Nr.Pasurie 1014/3,
ZK.1167*

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ **JO** ☐

- OE “T & XH” SHPK

L72121504I

*Tirane Godina: “Qendra e Biznesit Pajtoni”, Kati 3- të, Rruga Dytësore Tiranë-Durres, km1,
Tiranë*

Tipi i Kontratës: **Klasike**



Lloji i Procedurës së prokurimit: **“Procedurë e hapur - punë publike - prokurim me mjete elektronike”**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-52763-06-30-2025.**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Përmirësim i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Qendër Lindje, loti 4 (2025)”**

Fondi limit: 119,386,072.5 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e dy presje pesë) **Lekë pa TVSH.**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: **6.5 muaj**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **01.07.2025**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: **Data 07 Korrik 2025, Nr. 34**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto **X**

Sipas rëndësisë:

Çmimi ☐	pikët 60
Metodologjia ☐	pikët 5
Stafi / Organizimi i Kompanisë ☐	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social ☐	pikët 10
Periudha e garancisë të objektit ☐	pikët 10
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐	

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OE “DELTAREX” SHPK

L92314031R

Vlera: **76,413,640.00** (shtatëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **X**



Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. BOE “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” & “ALKO-IMPEX General Construcion” & “Signs & Road Safety Solutions” SHPK

K91628013D / K91326028I / L62228020U

Vlera: **79,991,857.53** (shtatëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë pesëdhjetë e tre) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. BOE “NDERTUESI 2014” SHPK & “UDHA” SHPK L46827004L / K77524909Q

Vlera: **93,867,711.00** (nëntëdhjetë e tre milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. OE “I.D.K-KONSTRUKSION” SHPK

K51408016J



Vlera: **95,489,652.00** (nëntëdhjetë e pesë milion e katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **285,00**

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ JO ☐

- OE "T & XH" SHPK

L72121504I

Tirane Godina: "Qendra e Biznesit Pajtoni", Kati 3- të, Rruga Dytësore Tiranë-Durres, km1, Tiranë

5. OE "RAFIN COMPANY" SHPK

L52125110A

Vlera: **113,409,118.20** (njëqind e trembëdhjetë milion e katërqind e nëntë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë pikë njëzet) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

* * *

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:



1. OE “DELTAREX” SHPK

L92314031R

Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Deltarex” sh.p.k, pasi oferta e paraqitur me vlerë 76,413,640 lekë pa tvsh., rezulton anomalisht e ulët.

Referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 4, citohet konkretisht:

4. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

⁸⁰Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

...

2. BOE “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” & “ALKO-IMPEX General Construcion” & “Signs & Road Safety Solutions” SHPK

K91628013D / K91326028I / L62228020U

Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Sign & Road Safety Solution & Alko Impex Construction & Alko Impex General Construction” sh.p.k, pasi nuk përmbushin kriteret e vecanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, kjo në kundërshtim me nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të LPP-së, konkretisht:

• BOE nuk përmbush kriterin sipas pikës 2.3.1 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.



Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë janë paraqitur sipas pikës 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

Operatori “Alko Impex Construction” sipas kontratës së bashkëpunimit është lider dhe merr përsipër të realizojë 61.9 % të punimeve. Kontratat e ngjashme të paraqitura nga ky operator me natyrën e objektit që prokurohet, nuk e përmbushin vlerën prej 61.9 % të dyfishit të fondit limit, kërkuar sipas këtij kriteri.

- BOE nuk përmbush kriterin **2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës**, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e kerkuara ne DST:

Mjetet e paraqitura nga bashkimi i operatorëve për këtë kriter nuk janë në përputhje me përqindjen e përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit kjo në kundërshtim me nenin 88 “Bashkimi i Operatoreve ekonomike”, Vendimit 285, date 19.05.2021 pika 3. “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. *Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”.

3. BOE “NDERTUESI 2014” SHPK & “UDHA” SHPK L46827004L / K77524909Q

Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDERTUESI 2014” SHPK & “UDHA” SHPK pasi nuk përmbushin kriteret e vecanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, kjo në kundërshtim me Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të LPP-së, konkretisht:

- BOE nuk përmbush kriterin **2.3.2 “Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.** Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e e kërkuara në DST”, pasi licenca profesionale e

paraqitur nga Operatori Ekonomik “NDERTUESI 2014” nuk përmban kategoritë e kërkuara, konkretisht NS-6-C.

Për kategorinë NS - 6/C (Sinjalistika rrugore jondricuese) bazuar në zërat dhe vlerën e perlllogaritur sipas procesverbalit të argumentimit përkon me kategorinë C (51-100 milion)

Referuar Akt Marrëveshjes për bashkimin e përkohshëm të shoqërive të datës 14.07.2025 midis shoqërisë “NDERTUESI 2014” shpk dhe shoqërisë “UDHA” shpk, për realizimin e shërbimit të këtij objekti vihet re që shoqëritë do të kryejnë punimet së bashku në masën:

-72.6 % Shoqëria “NDERTUESI 2014” shpk

-27.4 % Shoqëria “UDHA” shpk

Vlera e punimeve që operatori “ NDERTUESI 2014” ka marrë përsipër të realizojë për këtë kategori punimesh, referuar akt-marrëveshjes dhe ndarjes së punimeve është 52,662,200 lekë pa tvsh e cila përkon me kategorinë C / 51-100 milion.

Nga verifikimi i licencave të zbatimit të dorëzuara nga operatorët ekonomik, kriteri për kualifikim sipas pikës 2.3.2 NS - 6/C (*Sinjalistika rrugore jondricuese*) është plotësuar nga shoqëria “UDHA” shpk, i cili e disponon këtë licencë në kategorinë NS – 6/D por nuk është plotësuar nga operatori “NDERTUESI 2014” shpk., i cili e disponon këtë licencë në kategorinë NS – 6/A.

Për sa më sipër, kriteri në lidhje me disponimin e licencave nuk është plotësuar sipas ndarjes së realizimit të punimeve të marra përsipër në Akt Marrëveshje, duke ju referuar ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 80, “Parimet e procesit të përzgjedhjes”, Neni 3 “Parime të Përgjithshme”, Neni 92 “Shqyrtimi i ofertave” Pika 3, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ...,

- BOE nuk përmbush kriterin sipas pikës 2.3.1 **Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme*

a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së perlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*

b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë janë paraqitur sipas pikës 2.3.1/b *duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim*

Operatori “NDERTUESI 2014” sipas kontratës së bashkëpunimit është lider dhe merr përsipër të realizojë 72.6 % të punimeve. Kontratat e ngjashme të paraqitura nga ky operator me natyrën e

objektit që prokurohet, nuk e përmbushin vlerën prej 72.6 % të dyfishit të fondit limit, kërkuar sipas këtij kriteri.

BOE nuk përmbush kriterin **2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:**

- 1 (një) inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) inxhinier Mekanik
- 1 (një) inxhinier Mjediti
- 1 (një) inxhinier Topograf / Gjeodet / Markshajder

Ne formularin e vetdeklarimit të operatorëve ekonomike nuk është deklaruar Inxhinieri Mekanik i kërkuar sipas kriterit të mesiperm.

- BOE nuk përmbush kriterin **2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:**

-1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

-1 (një) punonjës që disponon certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores ”Për sigurinë në kantier”.

-1 (një) punonjës që të disponojë certifikatë si “Auditues/Insektues i Sigurisë Rrugore” (auditin e sigurisë rrugore dhe menaxhimin e pikave të zeza” lëshuar nga Institucionet Kompetente Shtetërore në përputhje me klauzolat e Direktivës 2008/96/EC ose ekuivalente

Stafi i deklaruar në formularin e vetdeklarimit për: “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” dhe “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” është i angazhuar në kontratën me objekt “Kontrata punimesh dhe Mirëmbajtje të rrugëve nacionale (kontratat e mirëmbajtjes), Rajoni Verior Shkodër” të lidhur me Autoritetin Kontraktor , kjo në kundërshtim me pikën 2.3.5 ku citohet * **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

Gjithashtu, stafi i paraqitur nga bashkimi i operatorëve për këtë kriter është plotësuar tërësisht nga operatori ekonomik “NDERTUESI 2014” shpk, i cili nuk është në përputhje me përqindjen e përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit kjo në kundërshtim me nenin 88 “Bashkimi i Operatoreve ekonomike”, Vendimit 285, datë 19.05.2021 pika 3. “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. *Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

- BOE nuk përmbush kriterin **2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e kërkuara në DST.**

Nga OE “NDERTUESI 2014” shpk, disa nga mjetet e vetdeklaruar në formularin e vetdeklarimit janë të angazhuara në kontratën “Kontrata punimesh dhe Mirëmbajtje të rrugëve nacionale (kontratat e mirëmbajtjes), Rajoni Verior Shkodër” të lidhur me Autoritetin Kontraktor”, kjo në kundërshtim me kërkesën: *Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar ne procedura te shpallura fitues.*

4. OE “RAFIN COMPANY” SHPK

L52125110A

Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “RAFIN COMPANY” sh.p.k, pasi nuk përmbush kriteret e vecanta te kualifikimit te percaktuara ne DST, kjo ne kundërshtim me nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të LPP-së, konkretisht:

OE nuk përmbush kriterin e veçantë “Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;”, pasi OE nuk ka paraqitur dokumentacion për vlerësim.

OE nuk përmbush kriterin 2.3.1 “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.”, duke marrë në konsideratë punën e ngjashme të paraqitur nga OE dhe vlerën e fondit limit.

OE nuk përmbush kriterin 2.3.2 “Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e e kërkuara në DST”, pasi licenca profesionale e paraqitur nga Operatori Ekonomik nuk përmban kategoritë e kërkuara, konkretisht NS-6-C.

OE nuk përmbush kriterin 2.3.5 “Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:

I (një) punonjes i pajisur me çertifikuar “Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave”, e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

I (një) punonjes që disponon çertifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne pune” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 ”Për sigurinë dhe

shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores ”Për sigurinë në kantier”.

1 (një) punonjes që të disponojë certifikatë si “ Auditues/ Insepektues i Sigurisë Rrugore (auditin e sigurisë rrugore dhe menaxhimin e pikave të zeza)” lëshuar nga Institucionet Kompetente Shtetërore në përputhje me klauzolat e Direktivës 2008/96/EC ose ekuivalente”,

OE nuk ka paraqitur 1 (një) punonjes që të disponojë certifikatë si “ Auditues/ Insepektues i Sigurisë Rrugore.

OE nuk përmbush kriterin 2.3.7 “Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet sipas tabelës në DST”, pasi OE nuk ka vetdeklaruar disponimin e të gjithë mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “I.D.K-KONSTRUKSION” SHPK**, me Nr. Nipti: **K51408016J** dhe me adresë: **Tiranë, Autostrada Tiranë-Durrës, Km.12, Rruga Zaja, Koder Berxulle, Nr.Pasurie 1014/3, ZK.1167**, me subjekt mbështetës **OE “T & XH” SHPK** me Nr. Nipti: **L72121504I** dhe me adresë: *Tirane Godina: “Qendra e Biznesit Pajtoni”, Kati 3- të, Rruga Dytësore Tiranë-Durres, km1, Tiranë*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **95,489,652.00** (nëntëdhjetë e pesë milion e katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) **Lekë pa TVSH** / totali i pikëve të marra sipas sistemit **[285,00]**, është identifikuar si fitues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Gentian Gjyli

